

Udhëzues mbi sigurimin e përgjegjësisë civile për kujdestarë/përfaqësues ligjorë vullnetarë

1. Me emërimin tuaj si kujdestar ligjor ju – pa qenë e nevojshme të jepni shpjegime të mëtejshme – jeni i mbrojtur në sajë të sigurimit kolektiv, mbi të cilin kanë rënë dakort Ministria e Drejtësisë së Land-it të Saksonisë së Ulët dhe shoqëria e sigurimeve Landschaftliche Brandkasse Hannover, për aq kohë sa ju nuk jeni punonjës në ndonjë shoqatë kujdestarësh ligjorë apo të një institucioni kujdestarie apo nuk e ushtroni kujdestarinë si profesion. Mbrojtja që ju ofron ky sigurim mbulon dëmet, të cilat ju i shkaktoni personit të cilin e keni në kujdestari, apo dëmet që mund t'ju shkaktohen si pasojë e zëvendësimit të dëmit që i shkaktoni një personi të tretë në kohën kur jeni duke ushtruar kujdestarinë. Mbrojtja që ofron ky sigurim i referohet gjithashtu edhe pretendimeve në rast dëmi nga personi për të cilin ju keni kujdestarinë dhe i cili mund të jetë një i afërm apo një person me të cilin jetoni në një shtëpi.

Në sigurim nuk përfshihet përgjegjësia civile private e kujdestarit ligjor. Për këtë arsye është i këshillueshëm një sigurim tjetër i përgjegjësive civile private.

Të siguruara janë gjithashtu edhe pretendimet në kuadër të kërkesave për kthimin mbrapsht të ndihmave sociale.

Këto janë shumat që mbulohen në kuadër të sigurimit në grup:

- a) për sigurimin e përgjegjësive në rast dëmtimi të pasurisë 250.000 € në një rast
- b) për sigurimin e përgjegjësive së përgjithshme 1,5 milionë gjithsej për dëmtime shëndetësore të personave dhe dëme materiale

Nuk parashikohet një kontribut nga ana juaj.

Në sigurim nuk përfshihen kërkesat e bëra si rrjedhojë e

- a) dëmeve nga aktivitetet tregtare llogaritëse, spekulative apo organizative
- b) dëmeve të shkaktuara si rezultat i faktit, që kontratat me shoqëritë e sigurimit nuk janë mbyllur apo nuk janë mbyllur konform rregullave të përcaktuara, nuk janë përmbushur apo nuk kanë vazhduar.

Të siguruara janë dëmet, që shkaktohen kur kujdestari ligjor ka neglizhuar mbylljen e kontratës për sigurimin shëndetësor vullnetar për personin, që ka në kujdestari.

- c) dëmeve që personi i siguar shkakton duke përdorur një automjet apo një karroceri.
- d) dëmeve që shkaktohen me qëllim.

2. Nëse personi për të cilin ju kujdeseni apo persona të tretë ngrenë pretendime ndaj jush për shkak të veprimtarisë si kujdestar, në mënyrë që të shmangni disfavoret, duhet të njoftoni mundësisht menjëherë

Shoqërinë e sigurimeve:

Landwirtschaftliche Brandkasse Hannover

SD-H-3,

Telefoni (0511) 362-1613

30140 Hannover

Mos harroni të bashkangjitni apo dërgoni një kopje të Gjykatës për Çështjet e Kujdestarisë përgjegjëse për ju, ku dëshmohet se i përkisni grupit të personave të cilët i përfshin sigurimi në grup/kolektiv.

Lidhur me pretendimet e ngritura ndaj jush në kuadër të veprimtarisë si kujdestar ju mund të njoftoni – gjithashtu sa më parë të jetë e mundur – Gjykatën për Çështjet e Kujdestarisë, bashkë me lutjen, që të njoftohet shoqëria e sigurimeve Landwirtschaftliche Brandkasse Hannover lidhur me kërkesën për dëmshpërblim.

Në lidhje me dëmet, për të cilat përgjigjet sigurimi juaj privat, duhet të njoftoni shoqërinë tuaj të sigurimeve dhe jo Gjykatën për Çështjet e Kujdestarisë.

3. Fillimisht ju nuk duhet të paguani për sigurimin në fjalë. Nëse personi, kujdestari i të cilit ju jeni, i ka mundësitë financiare dhe për këtë arsye ju nuk mund t'i kërkonit arkës së shtetit dëmshpërblim për shpenzimet tuaja (neni 1835 paragrafi 4 i Kodit Civil), mund t'ju kërkohet që kontributin vjetor për sigurimin ta paguani më vonë.

Me anë të Ligjit për Kujdestarinë është përcaktuar me ligj që, edhe shpenzimet e një sigurimi të arsyeshëm të përgjegjësisë civile për personin kujdestar janë shpenzime, të cilat kujdestarit në bazë të neneve 1835 paragrafi 2 fjalë 1, 1908i të Kodit Civil i rimbursohen.

4. Nëse ju si kujdestar ligjor jeni përgjegjës për një pasuri të konsiderueshme të personit mbi të cilin ushtroni kujdestarinë, atëherë ju keni të drejtë të vendosni për masat e mjaftueshme mbrojtëse. Shpenzimet për një sigurim të përshtatshëm juve ju paguhen nga pasuria e personit për të cilin keni kujdestarinë.

Ju jeni i lirë të vendosni, se në cilën shoqëri apo kompani sigurimesh dëshironi të jeni i siguruar. Gjithsesi ne dëshirojmë t'ju njoftojmë, që në kuadër të marrëveshjes së përgjithshme me shoqërinë e sigurimeve Landschaftliche Brandkasse Hannover, ju keni mundësinë të bëni kërkesë për një sigurim, i cili paguan dëmshpërblime të larta.

5. Sigurimi kolektiv përfundon

- me heqjen e së drejtës së kujdestarisë me vendim gjykate,
- me shkarkimin apo vdekjen e kujdestarit ligjor,
- me vdekjen e personit mbi të cilin ushtrohet kujdestaria.

Këshilla:

Në rastin e fundit kujdestari ligjor nuk është i autorizuar dhe i detyruar të veprojë. Procedura e varrimit dhe procedura e mëvonshme e trashëgimisë nuk janë në kompetencën e kujdestarit ligjor, gjithsesi veprimet emergjente, d.m.th. ato veprime, shtyrja për më vonë e të cilave mund të përbëjë rrezik, mund të kryhen deri sa trashëgimtari të gjejë mbështetje në mënyrë tjetër.

6. Informacionet e mësipërme vlejné parimisht edhe për përfaqësuesit ligjorë. Përgjegjëse në këtë rast është Gjykata për Çështjet Familjare.
7. Për informacione më të detajuara lidhur me këtë drejtohuni

1. përfaqësive lokale të shoqërive të sigurimeve

ose

2. Landschaftliche Brandkasse Hannover

IH 2,

Telefoni (0511) 362-3889

30140 Hannover.